



V E N D I M

Nr _____, datë _____

**MBI
TE DREJTEN E PUBLIKUT
PER TE MARRE INFORMACION MJEDISOR***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të Neneve 42 dhe 43 të Ligjit nr datë “Per Mbrojtjen e Mjedisit”, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:
SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Objekti

Ky vendim ka per objekt

- a) Te siguroje venien ne dispozicion te publikut dhe perhapjen e vazhdueshme, sistematike dhe ne nje mase sa me te gjere te informacionit mjedisor dhe te garantoje te drejten per te patur informacionin mjedisor qe disponohet nga autoritetet;
- b) Te percaktoje kushtet, menytrat dhe masat praktike per ushtrimin e te drejtes per te patur kete informacion, per perhapjen e tij tek publiku, per mundësimin e shkëmbimit te lire te mendimeve te publikut si dhe te pjesemarrjes se tij efektive ne vendim-marrjen mjedisore.

2. Përkufizime

Në këtë vendim termat e mëposhtme kane këtë kuptim:

- a) “**Autoritet Publik**” ka kuptimin e dhene në nenin 4 të Ligjit nr.. datë ...“Per Mbrojtjen e Mjedisit”;
- b) “**Aplikues**” eshte cdo person fizik dhe juridik që kërkon informacion mjedisor;
- c) “**Informacioni mjedisor**” ka kuptimin e dhene në nenin 42 të Ligjit nr datë “Per Mbrojtjen e Mjedisit”;
- d) “**Informacioni i mbajtur nga autoriteti publik**” eshte informacioni mjedisor i mbajtur nga autoriteti publik, qe e ka prodhuar, ose te cilit i eshte dhene ky informacion;

* Transpozohet Direktiva 2003/4/EC e Parlamentit European dhe e Keshillit e 28 Janarit 2003 mbi aksesin e publikut ne infromacionin mjedisor dhe qe shfuqizon Direktiven e Keshillit 90/313/EEC; 32003L0004 OJ L 041 , 14/02/2003 P. 0026 - 0032

- e) **“Informacioni i mbajtur per autoritetin publik”** eshte informacioni mjedisor, mbajtjen e te cilit, autoriteti publik perkates ia ka deleguar nje personi tjetër fizik apo juridik;
- f) **“Publik”** ka kuptimin e dhene në nenin 4 të Ligjit nr. datë “Per Mbrojtjen e Mjedisit”

SEKSIONI II

VENIA NE DISPOZICION DHE PERHAPJA E INFORMACIONIT MJEDISOR PER PUBLIKUN

3. Perhapja e informacionit mjedisor

- a) Autoritetet publike, me perjashtim te rastit te nen-paragrafit b), grumbullojnë dhe organizojnë infomacionin mjedisor qe lidhet me funksionet e tyre dhe qe mbahet nga ata apo per ata, per t’ia perhapur sistematikisht publikut me anë të internetit dhe/ose mjeteve te tjera elektronike te komunikimit kur disponohen mjete te tille komunikimi.
- b) Kërkesa per ta bere informacionin mjedisor te disponueshem me ane te internetit dhe/ose mjeteve te tjera elektronike te komunikimit nuk zbatohet per informacionin e grumbulluar perpara hyrjes ne fuqi te ketij vendimi, ne rastet kur ky nuk disponohet ne forme elektronike.
- c) Autoritet publike informojnë publikun ne menyren e duhur per të drejtat që ai gëzon ne kuader te ketij vendimi dhe ofrojnë informacion, udhezime dhe këshilla për këtë qëllim.
- d) Autoritetet publike ruajne infomacionin mjedisor që lidhet me funksionet e tyre në forma lehtësisht të riprodhueshme dhe të mundeshme per t’iu vene ne dispozicion publikut me anë të internetit dhe/ose mjeteve te tjera te komunikimit elektronik.

4. Informacioni qe i vihet ne dispozicion dhe i perhapet publikut

Autoritetet publike përkatëse vënë në dispozicion dhe i perhapin publikut, te pakten informacionin që vijon:

- a) Tekstet e traktateve, konventave e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe te Komunitetit European, te legjislacionit kombëtar ose vendor per mjedisin apo te legjislacionit qe lidhet me te;
- b) Politikat, planet dhe programet per mjedisin apo që lidhen me te;
- c) Raportet e progresit ne zbatim te nen-paragrafeve i dhe ii te ketij paragrafi, ne rastet kur ato pergatiten dhe/ose mbahen nga autoritetet publike ne forme elektronike;
- d) Raportet mbi gjëndjen e mjedisit te referuara ne paragrafin 5 te ketij vendimi;
- e) Të dhënat ose përmbledhjen e te dhenave te mbledhura nga monitorimi i aktiviteve që ndikojnë ose mund të ndikojnë në mjedis;

- f) Autorizimet, lejet dhe licencat per aktivitetet me ndikim të rëndësishëm në mjedis dhe marrëveshjet mjedisore ose një referencë për vendin se ku mund të kërkohet ose të gjendet ky informacion;
- g) Studimet për ndikimin në mjedis dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me perberesit e mjedisit, si ajri dhe atmosfera, uji, dheu, toka, peizazhi dhe zonat natyrore, përfshirë ligatinat, zonat bregdetare e detare, zonat e mbrojtura, diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij si dhe organizmat e modifikuar gjenetikiisht dhe ndërveprimin midis tyre, ose një referencë për vendin se ku mund të kërkohet ose të gjendet ky informacion.

5. Raportet mbi gjendjen e mjedisit

- a) Autoritetet publike përkatëse publikojnë raporte mbi gjendjen e mjedisit të paktën cdo katër vjet [cdo dy vjet]¹.
- b) Keto raporte hartohen në nivel kombëtar, dhe kur gjykohet e nevojshme edhe në nivel rajonal dhe vendor.
- c) Keto raporte përfshijnë, në mënyrë të veçantë, informacion mbi cilësinë e mjedisit dhe trysnitë e ushtruara mbi të.

6. Perhapja e informacionit mjedisor në rastin e një kërcënimi të mundshëm të afert

Autoriteti Publik, në rastin e një kërcënimi të mundshëm të afert për shëndetin publik ose mjedisin që shkaktohet nga aktivitetet njerëzore apo nga shkaqe natyrore, përhap menjehere dhe pa vonese të gjithë informacionin që disponohet prej tij ose për të tek publiku që mund të ndikohet, me qëllim që ky të marrë masa për të parandaluar ose minimizuar dëmet e mundshme.

SEKSIONI III PROCEDURAT PËR TË DREJTEN E MARRJES SE INFORMACIONIT MJEDISOR KUNDREJT KERKESËS

7. Marrja e informacionit mjedisor kundrejt kërkesës

- a) Autoriteti publik kundrejt kërkesës së aplikuesit vë në dispozicion të tij informacionin mjedisor që mbahet prej tij apo për të.
- b) Aplikuesi nuk është i detyruar të tregojë arsye për këtë kërkesë.
- c) Autoriteti publik vë informacionin e kërkuar në dispozicion të aplikuesit brenda një kohe sa më të shkurter por brenda një muaji nga dorëzimi i kërkesës.

8. Mënyrat ose formatet e perhapjes së informacionit mjedisor

¹ Duhet theksuar se ligji ekzistues mbi Mbrojtjen e Mjedisit i amenduar kërkon raporte të tilla cdo vit. Direktiva kërkon raporte “në intervale të rregullta që nuk i kalojnë katër vjet”. Drafti i ri LMM nuk i specifikon frekuencat e këtyre raporteve. Si rrjedhim lind nevoja për të diskutuar nëse raportet duhen bërë cdo 2 ose 4 vjet: nga njëra anë është më mirë të bëhen raporte më të shpeshta, por nga ana tjetër shtrohet pyetja nëse autoritetet publike që merren me këtë i kanë kapacitetet për të përgatitur raporte cdo 2 vjet.

- a) Autoriteti publik, me përjashtim të rastit të nen-paragrafit b) vë në dispozicion të aplikuesit informacionin mjedisor në atë mënyrë ose format që kërkohej prej tij, përfshirë këtu edhe kopje të dokumentave.
- b) Autoriteti publik, nuk e vë informacionin mjedisor në dispozicion të publikut sik kërkohej në paragrafin a) në rastet kur:
 - i. informacioni mjedisor është i disponueshëm publikisht në një mënyrë ose format tjetër, sikurse parashikohet në paragrafin 4 të këtij vendimi, dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga aplikuesi, ose
 - ii. autoriteti publik gjykon të arsyeshme t'ja vërë në dispozicion informacionin mjedisor në një mënyrë ose format tjetër, duke dhënë edhe arsyet respektive.
- c) Autoriteti publik, në rastin e nen-paragrafit b) i kthen aplikuesit përgjigje me shkrim për arsyet e refuzimit të vënies në dispozicion të informacionit mjedisor plotësisht ose pjesërisht, sipas mënyrës ose formatit të kërkuar, brenda një muaji nga kërkesa e tij.
- d) Autoritetet publike për qëllimet e këtij paragrafi, ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të ruajtur informacionin mjedisor që mbahet prej tyre në mënyra ose formate që janë lehtësisht të riprodhueshme dhe të aksesueshme me anë të mjeteve të telekomunikimit kompjuterik ose mënyrave të tjera elektronike.

9. Përgjegjësitë e autoritetit publik

Autoriteti publik ka këto përgjegjësi:

- a) Të mbështesë publikun kur kërkon informacion mjedisor.
- b) Të'i vërë në dispozicion dhe t'i bejë të aksesueshme listën e autoriteteve/institucioneve publike.
- c) Të përcaktojë masat konkrete që sigurojnë ushtrimin e të drejtës së publikut për të patur në dispozicion informacionin mjedisor, përfshirë këtu caktimin e punonjësve të informacionit, krijimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve dhe paisjeve për shqyrtimin e informacionit mjedisor të kërkuar dhe të regjistrave ose listave të informacionit mjedisor që disponohen nga autoritetet publike apo pikat e informacionit, me përcaktime të qarta se ku mund të gjendet ky informacion.

10. Vonesat në ofrimin e informacionit mjedisor si rezultat i volumit ose kompleksitetit të tij

- a) Autoriteti publik kur verën se volumi apo kompleksiteti i informacionit është i tillë që periudha prej një muaji, e referuar në paragrafin 7.c) nuk është e mjaftueshme, e vë në dispozicion të aplikuesit brenda dy muajsh nga dorëzimi i kërkesës së tij.
- b) Autoriteti publik informon aplikuesin për zgjatjen e afatit kohor të përmendur në nen- paragrafin a) përpara përfundimit të periudhës prej një muaji duke dhënë edhe arsyet për këto vonesa.

11. Vonesat në dhenien e informacionit mjedisor për shkak të paqartësisë së kërkesës

- a) Autoriteti publik, ne rastet kur kërkesa për informacion mjedisor është formuluar në mënyrë shumë të përgjithshme, i kërkon aplikuesit sa më shpejt të jetë e mundur por brenda një muaji nga kërkesa e tij, që të specifikojë kërkesën.
- b) Autoriteti publik ndihmon aplikuesin në specifikimin e kërkesës së tij, ne menyre të veçante duke i ofruar informacion mbi përdorimin e regjistrave publikë, siç përcaktohet në paragrafin 9.c).

12. Perjashtimet nga detyrimi për të përhapur informacionin mjedisor

- a) Autoriteti publik refuzon kërkesën për informacion mjedisor në rastet kur përhapja e këtij informacioni ndikon negativisht në:
 - i. konfidencialitetin e procedurave të autoriteteteve publike, kur ky është përcaktuar në Ligjin “Për ruajtjen e të dhënave personale” ose akte të tjera ligjore në fuqi;
 - ii. marrëdhëniet ndërkombëtare, sigurinë publike ose mbrojtjen kombëtare;
 - iii. në proceset gjyqësore, në mundësinë e një personi për të patur një proces gjyqësor të drejtë, ose në mundësinë e një autoriteti publik për të ndërmarrë një hetim me natyrë penale ose disiplinore;
 - iv. ruajtjen e sekretit tregtar ose industrial, në rastet kur këto parashikohen nga aktet ligjore në fuqi, ose në rastet e parashikuara në legjislacionin përkatës dhe që lidhen me ruajtjen e interesit të ligjshëm ekonomik, përfshirë edhe interesin publik për të ruajtur sekretin për statistikën dhe taksat;
 - v. të drejtat e pronësive intelektuale;
 - vi. ruajtjen e të dhënave personale dhe/ ose dosjeve që lidhen me një person fizik, kur ky person nuk ka dhënë miratimin e tij për ta bërë publik këtë informacion, sikurse parashikohet në Ligjin “Për ruajtjen e të dhënave personale” ose akte të tjera ligjore në fuqi;
 - vii. interesat ose mbrojtjen e çdo personi që ka dhënë informacionin e kërkuar në baza vullnetare kur nuk kishte detyrimin ligjor për ta bërë këtë, apo nuk ishte e mundur të vihej nën këtë detyrim, po që se personi nuk ka miratuar me pare publikimin e këtij informacioni;
 - viii. mbrojtjen e mjedisit, me të cilin lidhet ky informacion, si psh vendndodhjen e specieve të rralla.
- b) Autoriteti publik mund ta refuzojë sipas rastit kërkesën për informacion mjedisor kur:
 - i. informacioni i kërkuar nuk mbahet nga ose për autoritetin publik, të cilit i është bërë kërkesa. Në rastet kur autoriteti publik ka dijeni se ky informacion mbahet nga ose për një autoritet tjetër publik, ai ja transferon kërkesën atij autoriteti, sa më shpejt të jetë e mundur dhe për këtë njofton me shkrim aplikuesin. Autoriteti publik mundet gjithashtu të informojë dhe keshillojë aplikuesin për t’ja drejtuar vetë kërkesën e tij autoritetit përkatës të sugjeruar;
 - ii. kërkesa është qartësisht e paarsyeshme;
 - iii. kërkesa është formuluar në mënyrë shumë të përgjithshme, sipas parashikimit të Paragrafit 11;

- iv. kërkesa lidhet me materiale, të dhëna apo dokumente që janë në procesin e përgatitjes apo të papërfunduara. Autoriteti publik, në këtë rast informon aplikuesin për emrin e autoritetit që përgatit materialin dhe kohën që nevojitet për përgatitjen e tij;
- v. kërkesa lidhet me komunikime të brendshme dhe merr parasysh interesin publik për dhenien e këtij informacioni;
- c) Autoriteti publik përpara se të marrë vendim rast pas rasti për të refuzuar pjesërisht ose plotësisht kërkesën për informacion mjedisor, merr në konsideratë interesat publike pro dhe kundër përhapjes së informacionit.
- d) Autoriteti publik, për qëllime të nen-paragrafit a) pikat i, iv, vi, vii dhe viii të këtij paragrafi, nuk refuzon kërkesën për informacion mjedisor, kur kjo kërkesë lidhet me dhenien e informacionit për shkarkimet në mjedis.
- e) Informacioni mjedisor që mbahet nga apo për autoritetin publik, të cilit i vjen një kërkesë nga aplikuesi, bëhet i disponueshëm pjesërisht, në rast se është e mundur të veçohet informacioni që është subjekt i nen-paragrafit a) ose b) pika iv, v e këtij paragrafi.

13. Arsyet e refuzimit për dhenien e informacionit

- a) Autoriteti publik i jep aplikuesit arsyet e refuzimit për dhenie të informacionit të plotë apo të pjesshëm, me shkrim ose në mënyrë elektronike.
- b) Autoriteti publik jep arsyet e përmendura në nen-paragrafin a) të këtij paragrafi brenda afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 8, pika c) ose në paragrafin 10 të këtij vendimi.
- c) Autoriteti publik, njëkohësisht me arsyet për refuzim, informon aplikuesin edhe për të drejtat që ai ka për të apeluar në rrugë administrative apo gjyqësore vendimin e refuzimit, siç përcaktohet në paragrafin 15 të këtij vendimi.

Seksioni IV DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

14. Tarifat për marrjen e informacionit mjedisor

- a) Aksesin në cdo regjistër publik ose listë të krijuar ose mbajtur në përputhje me paragrafin 9.a.iii të këtij vendimi si dhe shqyrtimi i informacionit të kërkuar në vendin e mbajtjes së tij, është falas.
- b) Autoriteti publik përcakton një tarifë të arsyeshme për tu paguar nga aplikuesi për të marrë informacionin e kërkuar.
- c) Autoriteti publik bën publike listën e këtyre tarifave dhe rrethanat kur kjo tarifë duhet paguar ose jo.

15. Ankimimi Administrativ dhe Gjyqësor

- a) Cdo person, kur konstaton se janë shkelur të drejtat e tij të njohura nga ky vendim, ankimon në rrugë administrative ashtu siç përcaktohet në nenin 15 të

ligjit nr. 8503, datë 30.6.1999 “Mbi të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”.

- b) Cdo person, kur konstaton se janë shkelur të drejtat e tij të njohura nga ky vendim, ankimon ne rruge gjyqesore, ashtu siç përcaktohet në nenin 16 të ligjit nr. 8503, datë 30.6.1999 “Mbi të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”.

16. Sanksione

Përfaqësuesi i autoritetit publik qe i jep aplikuesit informacion të rremë, qe ndryshon, prish, bllokon, fshin, shkatërron ose fsheh ndonjë nga të dhënat që mbahen nga ai autoritet, qe aplikuesi ka të drejtën t’i marrë, eshte subjekt i dispozitave të Nenit 186 të Kodit Penal të Shqipërisë.

17. Zbatimi

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi.

18. Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit të tij në fletoren zyrtare.